



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr 020/19 - 5769 dt. 20/01/2020

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenin 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesës Nr.01-070-2586, e ushtruar ndaj Vendimit të Inspektoratit të Ndërtimit

- I.** Formohet Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës Nr.01-070-2586, e ushtruar ndaj Vendimit të Inspektoratit të Ndërtimit, në këtë përbërje:
1. Shqipdon Zariqi, (kryetar),
 2. Albulena Lushtaku, (anëtar),
 3. Shehrie Mustafa, (anëtar).
- II.** Komisioni është përgjegjës që të shqyrtojë ankesën Nr.01-070-2586, e ushtruar ndaj Vendimit të Inspektoriatit të Ndërtimit.
- III.** Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese komisioni i lartëcekur është i obliguar që të hartojë procesverbal dhe për këtë ankesë duhet të marrë vendim për miratimin apo refuzimin e saj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës dhe e njëjta duhet t'i dërgohet parashtruesit të

ankesës. Komisioni obligohet që të hartojë raport me shkrim për ankesat e shqyrtuara dhe i dërgohet Kryetarit të Komunës.

IV. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

V. Komisioni i formuar sipas pikës I (një) të këtij Vendimi ka mandat vetëm për ankesën Nr.01-070-2586.

VI. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

VII. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtareve të Komisionit;
- Drejtorisë së Inspeksionit;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.